



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

---

Numri i lëndës: 2018:010670

Datë: 01.04.2019

Numri i dokumentit: 00264262

P.nr. 221/18

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore Prizren - dega në Suharekë, Gjyqtari Robert Tunaj, me sek. Juridike F. Kabashi, në lëndën penale kundër të akuzuarit Xh. E. nga Suhareka Rr."K. K.", për shkak të veprave penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP, e duke vendosur sipas aktakuzës të PTH në Prizren PP.II.nr.877-6/17 të datës 26.04.2018, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.01.04.2019, në prezencë të PSH Sahide Sefa, i akuzuari, muarrë dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari Xh. E. nga i ati Xh., i lindur me dt.01.08.1963, jeton në Suharekë, i martuar, baba kater fëmijeve, ka përfunduar arsimin e mesëm, puntor, i gjendjes të mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Se prej datës së pavërtetuar e deri me dt.30.01.2017, në Suharekë, pikërisht në lokalitetin e tij, përfiton nga shërbimet komunale përmes rrjetit përques të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes pa autorizim të shfrytëzuesit të autorizuar, në atë mënyrë që ka shfrytëzuar energjinë elektrike, përmes një lidhje direkte mbrapa objektit kabllin i degëzuar nga konzulla jashtë njesorit elektrik. Ashtu që energjia elektrike e shpenzuar nuk regjistrohet me c'rast ndërmarrjes së demtuar KEDS- Departamenti ligjor në Prizren i ka shkaktuar dëm material.

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP.

Gjykata në kuptim të neneve 41,42,46,51,52,73, 74 si dhe nenit 320 të KP, të akuzuarit, ia shqipton:

**DËNIM ME GJOBË**

Kunder të akuzuarit Xh. E. për shkak të veprës si në dispozitivin e akuzës gjykata i shqipton **dënim me gjobë në shume prej 200 euro**, dënim ky i cili duhet të paguhet në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmeris së këtij aktgjykimi e në rast se nuk paguhet zëvendësohet me 10 ditë burg.

**DËNIMIN ME KUSHT**

Të akuzuarit **Xh. E.** gjykata ia shqipton **dënimin me burg prej 6 muaj, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari në afat prej 1 viti, nuk kryen veprë të njejtë apo të ngjajshme penale.**

Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës në emër të pasuahlit gjyqësor shumën prej 30 euro dhe në emër të taksës për kompenzimin e viktimave 30 euro.

E dëmtuara KEDS udhëzohet në kontest të rregullt civil.

### Arsyetim

PTH në Prizren me aktakuzën PP.II.nr. 877-6/17 të dt.26.04.2018 ka akuzuar Xh. E. nga Suhareka, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP, aktakuzën të cilën gjatë seances gjyqësore prej fillimit gjerë në mbarimin e saj e ka perfaqësuar PSH Sahide Sefa, e cili në tërsi ngel si në aktakuzë, me kërkesë që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.01.04.2019 dhe në vetë pranimin nga ana e të akuzuarit, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se prej datës së pavërtetuar e deri me dt.30.01.2017, në Suhareke, pikërisht në lokalitetin e tij, përfiton nga shërbimet komunale përmes rrjetit për shkak të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes pa autorizim të shfrytëzuesit të autorizuar, në atë mënyrë që ka shfrytëzuar energjinë elektrike, përmes një lidhje direkte mbrapa objektit kabllor i degezuar nga konzulla jashtë njesorisë elektrike. Ashtu që energjia elektrike e shpenzuar nuk regjistrohet me c' rast ndërmarrjes së demtuar KEDS- Departamenti ligjor në Prizren i ka shkaktuar dëm material.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vetë pranimi i të akuzuarit i cili në shqyrtim gjyqësor e ka pranuar fajsin.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 259 të KPP në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë të pa pranueshme dhe poashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsis, pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit është bërë vullnetarisht në shqyrtimin gjyqësor, pranimi është mbështetur në faktet e qështjes që përmban aktakuza, siq janë, procesverbalit i Qendres së Kalibrimit procesverbalit me nr.24..... të dt. 30.01.2017, në fakturën e konsumatorit, Divizioni i Furnizimit DPZ17HP1....., si dhe fotodokumentacioni, të cilat gjenden në shkresat e lëndës si provë materiale të paraqitura ndaj të akuzuarit nga ana e PTH në Prizren.

Gjykata poashtu në tërsi ka ardhur në përfundim se pranimi i fajsis është bërë në mënyrë vullnetare i vetëdijshëm dhe në përputhje me nenin 248 nga se nuk egziston ndonjë nga arsyerat dhe kushtet për hulumtimin e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale si dhe nenit 253 të KPP. Dhe nga këto fakte të cilat i përmban aktakuza, gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimin e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qënjes së veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP, gjykata ka vendosur të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ia shqiptoi dënimet siqë është cek në aktgjykim.

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ka vlersuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KP.

Gjykata si rrethanë letësuese pati parasysh se i akuzuari ka patur qëndrimin korrekt ndaj gjykatës, pranimin në tërsi të veprës së kryer, është penduar për veprën e kryer, i pa punë, kurse rrethanë rënduese faktin se edhe më parë ka qenë i denuar me aktgjykim të plotëfuqishëm P.nr.123/17 për veper të natyres së njëjt.

Vendimi mbi kërkesën pasuroro juridike u muarrë në kuptim të nenit 463 të KPP

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u muarrë në kuptim të nenit 452 paragrafi 1 të KPP.

Vendimi me të cilin është obliguar i akuzuari që të bëjë kompensimin e viktimës së krimit është marrë konform nenit 39 paragrafi 3 nënparagraf 3.2 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHËSHEM**  
**P.nr. 221/18 te dt.01.04.2019**

Sek. Juridike  
F. Kabashi

G j y q t a r i  
Robert Tunaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.